



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 51

Prishtinë, më 12.2.2019, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Bahrim Shabani, Frashër Krasniqi, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Xhevahire Izmaqu, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

Munguan: Hajdar Beqa dhe Jelena Bontiq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Shaban Murturi, Eusr/Euo, Edita Kryeziu, Ambasada Amerikane, Tim Hammer, Ambasada Amerikane, Albert Haliti, KDI, Blerta Bejtullahu, Eusr/Eu office, Besiana Dauti, “Ekonomia online”, Dardane Neziri, “Koha ditore”, Etrur Maloku, Ambasada Amerikane, Genc Nimoni, “Çohu”, Arbelira Dedushaj, D+, Bardha Smajli, D+, Rreze Hoxha, GLPS, Nehat Dervishi, OSBE, Arbisa Shefkui, Kallxo/Birn.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit.

Nga stafi mbështetës: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më datë 20 dhe 27.11.2018 dhe 4.12.2018;
3. Shqyrtimi në parim i Projektkodit të Procedurës Penale nr. 06/L-151;
4. Shqyrtimi i raportit plotësues me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr.06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit, të datës 11.12.2018;
5. Formimi i grupit punues për monitorimin e Ligjit nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit te ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më datë 20 dhe 27.11.2018 dhe 4.12.2018

Kryetarja, konstatoi se komisioni miratoi procesverbalet, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektkodit të Procedurës Penale nr. 06/L-151

Kryetarja, në lidhje me Kodin e Procedurës Penale, paraqiti vërejtje në nenin 177, i cili flet për suspendimin e personit zyrtar nga detyra, ku tha se ka pasur diskutime që ky nen të vlejë vetëm për kapitullin 23 të Kodit Penal, që lidhet me veprat penale kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, por kështu siç është në Kodin e Procedurës Penale, është e papranueshme. Rrjedhimisht e bën të papranueshëm edhe draft-kodin, tha mes tjerash deputetja Albulena Haxhiu. Një vërejtje tjetër e paraqitur nga znj. Haxhiu është edhe gjykimi në mungesë, ku tha se në kod janë përfshirë të gjitha veprat penale, por së pari duhet të aplikohet shqyrtimi fillestar dhe shqyrtimi kryesor, kur dihet se rastet e krimeve të luftës është problem që të sigurohet prezenca e të dyshuarit në shqyrtim fillestar apo shqyrtim kryesor, prandaj edhe ka lindur ideja që duhet të jenë rrethana tjera kur kërkohet gjykimi në mungesë, potencoi deputetja Haxhiu. Në fund, tha se çështja tjetër ka të bëjë me propozimin nga një grup organizatash të shoqërisë civile, ku është kërkuar që aktakuzat në kohën kur shkojnë në gjykatë nga prokuroria, të jenë publike, me përjashtim të të dhënave konfidenciale.

Xhevahire Izmaku, tha se ky kod e plotëson pakon e ligjeve, që e ndihmojnë reformën në sferën e drejtësisë, në veçanti, neni i ri i shtuar në lidhje me gjykimin në mungesë, kur dihet se ka shume raste të krimeve të luftës, ku ka munguar baza ligjore për t'u dënuar ata që kanë kryer krime lufte dhe tani jetojnë të lirë në Serbi, ndërsa me këtë ligj, do të ketë mundësi që këta persona të dënohen, gjë që do të na shërojë shpirtërisht dhe juridikisht, theksoi znj. Izmaku. Më pas, shtoi se pas miratimit në parim, është mirë që të angazhohen ekspertë të fushës, që të punohet në mënyrë sa më profesionale në draftimin e Kodit të Procedurës Penale.

Kryetarja theksoi se, sa herë që ka ligje voluminoze, komisioni angazhon ekspertë, zakonisht profesorë të Fakultetit Juridik, që njohin fushën penale, të cilët gjithsesi do të angazhohen nëse projekt-kodi kalon në parim.

Bilall Sherifi, tha se sikur Serbia të ishte kooperative me dorëzimin e të dyshuarve për krime lufte dhe sikur të ishin përfshirë në Gjykatën Speciale edhe krimet e kryera nga forcat serbe, nuk do të kishte nevojë që në këtë ligj të përfshihej gjykimi në mungesë, sepse do të sigurohej një mekanizëm detyrues për Serbinë, që t'i dorëzojë kriminelët e luftës. Pra, duke pasur parasysh këto dy fakte, është e domosdoshme kjo dispozitë në ligj, theksoi mes tjerash deputeti Sherifi.

Frashër Krasniqi, tha se me vërejtjet që u dhanë nga parafolësit, do ta votojë projektligjin, duke lënë mundësinë që të plotësohet me amendamente ose edhe gjatë grupit të punës.

Korab Sejdiu, vlerësoi punën që është bërë në Kodin e Procedurës Penale, në përgjithësi, duke thënë se si komision dhe si Kuvend e kemi obligim të mbrojmë plasimin e dënimit në mungesë, brenda këtij kodi për dy arsye kyçe, ku njëra veç është elaboruar, sa i përket krimeve të luftës, ndërsa një çështje tjetër e një rëndësie të jashtëzakonshme është fakti se ka numër të madh të aferave të korrupsionit, që përfshijnë një numër të madh të zyrtareve deri në 60 të pandehur, ku ka një marrëveshje mes tyre, që të dështojnë seancat duke munguar një avokat ose një i pandehur me shpresën që të vijë deri te parashkrimi i veprave për të cilat edhe akuzohen, pra ky është përfitimi i dytë i dënimit në mungesë përpos atij primar që është çështja e krimeve të luftës theksoi deputeti Korab Sejdiu. Më pas, shtoi se edhe çështja e suspendimit të zyrtarëve publikë, mënyra siç është në projektкод nuk është adekuate. Ai tha se së paku duhet të ketë konfirmim të aktakuzës, para se te ketë suspendim. Pra, duhet pasur kujdes sesi hartohet ky nen. Gjithashtu, z. Sejdiu përmendi edhe çështjen e përjashtimit të avokatëve, me pamundësi të ankesës nga avokati i përjashtuar. Në fund, u pajtua që në punimet e grupit të punës për këtë projektкод, të jenë të ftuar edhe anëtarët e grupit hartues, kur dihet se në atë grup ka pasur një numër të ekspertëve shumë të mirë.

Kryetarja, tha se neni 306, më shumë duket që është shkruar për krimet ordinere, sesa për krimet e luftës, prandaj edhe nuk e kemi tërhequr projektligjin, i cili do të jetë në seancën e ardhshme.

Xhevahire Izmaku, tha se në projektкод, neni në fjalë flet qartë për gjykimin në mungesë për krime të luftës. Po ashtu, beson shumë që Kosova do të jetë pjesë e strukturave evropiane e botërore të inteligjencës, që do t'i arrestojnë këta kriminelë, në momentin kur të hyjë në fuqi projektkodi. Deputetja Izmaku kishte vërejtje në lekturën e projektkodit, ku tha se ka mangësi në aspektin e ndërtimit të fjalive.

Sami Kurteshi, tha se propozimi i Lëvizjes Vetëvendosje është shumë më i kompletuar dhe më i detajuar, dhe nëse e heqim atë propozim dhe lihet propozimi i Qeverisë, mendoj se do të ketë probleme më vonë.

Arben Gashi, tha se meqenëse gjykimi në mungesë rregullohet me Kod të Procedurës Penale, nuk ka nevojë të rregullohet me një ligj të veçantë. Ai më tej shtoi se propozimi i Vetëvendosjes mund të shndërrohet në amendament, në mënyrë që të mos ketë konfuzion në lidhje me këtë çështje.

*Meqë nuk kishte diskutime tjera, kryetarja konstatoi se me **katër** vota “**për**” **katër** “**abstenime**”, komisioni nxori këtë:*

Rekomandim

Të mos miratohet, në parim, Projektkodi i Procedurës Penale nr. 06/L-151.

4. Shqyrtimi i raportit plotësues me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit të datës 11.12.2018

Kryetarja paraqiti për shqyrtim, raportin plotësues me amendamente te Komisionit funksional në Projektligjin nr.06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit, të datës 11.12.2018, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen, nëse kanë vërejtje për këtë raport.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.
5. **Formimi i grupit punues për monitorimin e Ligjit nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik**

Pas diskutimeve, komisioni nxori këtë:

V e n d i m

për formimin e grupit punues për monitorimin e Ligjit nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

1. Formohet grupi punues për monitorimin e Ligjit nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, me këtë përbërje:
 1. Albulena Haxhiu, kryesuese,
 2. Hajdar Beqa, anëtar,
 3. Korab Sejdiu, anëtar,
 4. Bahrim Shabani, anëtar.

6. Të ndryshme

Komisioni shqyrtoi shkresën e dorëzuar nga Flamur Murtezi nga Gjilani, me të cilën kërkon nga komisioni, që të anulohet konkursi i shpallur nga Ministria e Drejtësisë për pranimin e 120 zyrtarëve korrektues në SHKK.

Komisioni, duke u bazuar në nenet 219 dhe 220 të Ligjit nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale, Rregullores nr.13/2018 për procedurën e rekrutimit të zyrtarëve korrektues në Shërbimin Korrektues të Kosovës, vlerësoi:

- Komisioni nuk është kompetent për anulimin e konkursit të shpallur nga Ministria e Drejtësisë;
- Procedura për rekrutimin e zyrtarëve korrektues është përcaktuar me Rregulloren nr.13/2018, për procedurën e rekrutimit të zyrtarëve korrektues në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Në nenin 23 të Rregullores nr.13/2018, përcaktohet procedura e shqyrtimit të ankesave dhe atë:

1. Pas publikimit të listës përfundimtare të kandidatëve të suksesshëm, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, kandidati i pakënaqur ka të drejtë të parashtojë ankesë.
2. Ankesa i drejtohet me shkrim Komisionit ad-hoc të ankesave të SHKK-së, i cili emërohet me vendim nga drejtori i përgjithshëm i SHKK-së dhe përbëhet nga kryesuesi dhe dy anëtarë, nga radhët e personelit të SHKK-së.
3. Komisioni shqyrton dhe vendos për ankesat në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të ankesës.
4. Ndaj vendimit të Komisionit të ankesave, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në organin përkatës për shqyrtimin e kontesteve nga marrëdhënia e punës.

Andaj, duke u bazuar në konstatimet e theksuara, pala udhëzohet të ndjekë procedurat e përcaktuara më lart.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,
Albulena Haxhiu
